

KONTRATE DHURIMI KUOTASH / PJESE

TE SHOQERISE "KKG Project" sh.p.k.

Sot me date 26/04/2023, PALA DHURUESE dhe PALA PRANUESE E DHURIMIT, kane rene dakort per redaktimin e kesaj kontrate DHURIMI KUOTASH / PJESE me termat si me poshte vijon:

PALA DHURUESE:

Z. Realdo Mansaku, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me date 31.03.1987, identifikuar me Karten e Identitetit me Nr.033575520 dhe personal Nr.I703310600, me adrese Rr. "Sami Frasheri, Nd.19, H.8, Tirane dhe email realdomansaku@gmail.com (ne vijim referuar si "Dhuruesi").

Zoterues i 30 % te kuotave te kapitalit te shoqerise me vlere totale prej 30,00 (tridhjete) Para.

PALA PRANUESE E DHURIMIT:

Z. Grigor Bele, shtetas shqiptar, lindur ne Fier me date 30.03.1994, identifikuar me pasaporten me Nr.BG2828638 dhe personal Nr. J40330072H, me adrese Rr. "Anastas Kullorioti", Tirane. (ne vijim referuar si "Pranuesi i Dhurimit").

Ketu e ne vijim Dhuruesi dhe Pranuesi i Dhurimit do te referohen si "Pale" dhe se bashku si "Palet"

Palet bien dakord si me poshte vijon:

NENI 1

Kushte te pergjithshme

1.1. Pala dhuruese **Z. Realdo Mansaku**, eshte ortak i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "KKG Project" Sh.p.k, regjistruar ne menyre te rregullt ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR) si person juridik, i pajisur me Numer Unik Identifikimi te Subjektit NUIS (NIPT) L41915003F, me seli ne Tirane, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga "Sami Frasheri", Nd.19, H.8; i cili zoteron respektivisht:

Z. Realdo Mansaku, 30 (tridhjete) % (Perqind) te kuotave te kapitalit te shoqerise me vlere totale prej 30,00 (tridhjete) Para.

Ky fakt vertetohet dhe nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar te leshuar nga QKR, per Shoqerine "KKG Project" Sh.p.k, qe i bashkelidhet kesaj kontrate.

Z. Realdo Mansaku, garanton se eshte pronari i ligjshem i kuotave te zoteruara prej tij ne shoqeri dhe nuk ka asnje pengese ligjore dhe/ose nuk i nevoitet asnje tager tjeter ligjor per te lidhur kete kontrate, dhe per te permbushur detyrimet qe rrjedhin prej saj.

1.2. Me Vendimin e Asamblese se ortakeve Nr.3/2023 te dates 26.04.2023 te Shoqerise "KKG Project" Sh.p.k, eshte vendosur dhurimi i 30 % te kuotave te kapitalit te shoqerise "KKG

Project” Sh.p.k nga ortaku ekzistues, **Z. Realdo Mansaku** disponon, tek pala pranuese e dhurimit **Z. Grigor Bele**.

NENI 2 OBJEKTI

Objekt i kesaj kontrate eshte dhurimi ne total nga pala dhuruese, **Z. Realdo Mansaku**, qe perben 30 % te kapitalit total te Shoqerise “**KKG Project**” Sh.p.k, tek pala pranuese e dhurimit **Z. Grigor Bele**.

NENI 3 BAZA LIGJORE

Baza ligjore e kesaj kontrate dhurimi neni 761 e vijues te Kodit Civil, Ligji 9901, date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, (i ndryshuar).

NENI 4 TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE

- 4.1 Pas miratimit te Vendimit Nr.3/2023 te dates 26.04.2023 te Asamblese se shoqerise “**KKG project**” Sh.p.k, me ane te kesaj kontrate dhurimi, **Z. Realdo Mansaku** i kalon ne pronesi pranuesit te dhurimit **Z. Grigor Bele**, 30 % te kapitalit qe **Z. Realdo Mansaku** zoteron.
- 4.2 Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhurimi, **Z. Realdo Mansaku** zhvishet nga pronesia e 30% te kapitalit te Shoqerise “**KKG Project**” Sh.p.k dhe pranuesi i dhurimit **Z. Grigor Bele** behet perfituesi i 30 % te kapitalit qe zoteronte **Z. Realdo Mansaku** te shoqeria “**KKG Project**” Sh.p.k.

NENI 5 EFEKTE LIGJORE

- 5.1 Palet bien dakord se me nenshkrimin e kesaj kontrate, Pranuesi i Dhurimit behet pronar me te drejta te plota te kuotave respektive te dhuruara, sipas percaktimit te kesaj kontrate, si me siper dhe Dhuruesi zhvishet nga cdo e drejte lidhur me keto kuota.
- 5.2 Me nenshkrimin e kesaj kontrate, pjesmarrja ne Shoqerine “**KKG Project**” Sh.p.k do te jete si me poshte:
 - **Z. Grigor Bele** behet zoterues i 30 % (tridhjete perqind) i kuotave te kapitalit te shoqerise “**KKG Project**” Sh.p.k.
 - **Z. Henri Aleks**i behet zoterues i 70 % (shtatedhjete perqind) i kuotave te kapitalit te shoqerise “**KKG Project**” Sh.p.k

NENI 6 TE NDRYSHME

- 6.1 Kesaj kontrate i bashkelidhen dhe jane ne pjese perberese e saj dokumentacioni si me poshte:
 - Ekstrakti i QKR-se historik i shoqerise “**KKG Project**” Sh.p.k;

- Vendimi i asamblese i shoqerise "KKG Project" Sh.p.k.

6.2 Kjo eshte nje kontrate dhurimi kuotash e perpiluar ne 4 kopje dhe pasi lexohet me ze te larte dhe gjendet ne perputhje te plote me vullnetin e paleve kontraktuese, nenshkruhet rregullisht prej tyre.

PALET :

PALA DHURUESE

Z. Realdo Mansaku

Realdo Mansaku


PALA PRANUESE E DHURIMIT

Z. Grigor Bele

Grigor Bele
